



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1664/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitja Ymeri, anëtarë në çështjen juridike të paditësit N.SH “Grand Media”, me seli në Zonën Industriale, Prishtinë, me NRB 702268875, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.R., avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Radio Televizioni i Kosovës, me seli në rrugën Xhemail Prishtina, nr.12, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.Z., avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,963.751.32 €, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhetë paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës- Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.829/22 e datës 18.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 19.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit N.SH “Grand Media”, me seli në Zonën Industriale, Prishtinë dhe ankesa e të paditurës Radio Televizioni i Kosovës, me seli në Prishtinë PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, KE.nr.829/22 e datës 18.08.2023, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik me aktgjykimin KE.nr.829/22 e datës 18.08.2023, ka vendosur si në vijim:

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.SH “Grand Media”, dhe DETYROHET i padituri Radio Televizioni i Kosovës, që në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e mospërmbushjes së kontratës nr.1283/11, të ia paguaj paditësit shumën prej 340,808.00 € dhe në emër të borxhit shumën prej 32,933.54 €, gjithsej shumën e përgjithshme në vlerë prej 373,741.54 € (treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e katërdhjetë e një euro e pesëdhjetë e katër cent) me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale në periudhë kohore prej një viti, të llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, me datën 28.05.2014, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit N.SH “Grand Media”, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Radio Televizioni i Kosovës, që në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e mospërmbushjes së kontratës nr.1283/11, të ia paguaj paditësit në emër të fitimit të humbur shumën prej 1,339.943.14 € si dhe në emër të fitimit të humbur nga marketingu dhe sponsorët shumën prej 250,066.64 €, me kamatë ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 28.05.2014, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- III. DETYROHET i padituri që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 6,215.00 € (gjashtë mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë euro), në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur paditësi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet e bazuar ankesa e paditësit N.SH “Grand Media” me seli në Prishtinë, dhe të ndryshohet pika II e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike Ke.nr.829/22 e datës 20.07.2023, ashtu që të detyrohet i

padituri Radio Televizioni i Kosovës që në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e mos përmbushjes së kontratës nr.1283/11 t'ia paguaj paditësit në emër të fitimit të humbur shumë prej 1,680.754.24€, me kamatë ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8% duke filluar nga data 28.05.2014 e deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka parashtruar ankesë edhe i padituri Radio Televizioni i Kosovës, paditësi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ta ndryshoj Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike Ke.nr.829/22 e datës 20.07.2023, dhe ta njoh vlerën reale të borxhit prej 32,934.52€ për të cilën i obligohet pala e paditur ndaj paditësit.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit dhe të paditurit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi N.SH "Grand Media", me datën 28.05.2014, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi për mos përmbushjen e kontratës nr.1283/11 për transmetimin e emisionit "Kush do të bëhet Milioner", kundër të paditurit Radio Televizioni i Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri, që paditësit të ia paguaj shumë prej 1,463.117.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Me datën 29.03.2016 dhe 11.07.2016 paditësi ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, duke kërkuar që të detyrohet i padituri që paditësit në emër të dëmit material të ia kompensoj shumë e përgjithshme në vlerën prej 3,402.637.00 €.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së palës së paditur, me aktvendimin Ar.nr. 127/18 të datës 03.02.2020, e ka aprovuar ankesën e të paditurës si të themeltë dhe ka prishur aktgjykimin III.EK.nr.541/15 të datës 09.03.2018 të gjykatës së shkallës së parë dhe të njëjtën çështje e ka kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Ka theksuar që nga ekspertiza financiare si dhe nga super ekspertiza e datës 30.09.2021, dhe plotësimi i saj i datës 20.02.2022, është vërtetuar pa asnjë dyshim se Kontrata 5 asnjëherë nuk është shkëputur, pasi që kjo Kontratë, sipas nenit 14 është dashur të shkëputet me paralajmërim, si dhe dëmi i pësuar nga kjo mos përmbushje, duhet të kompensohet nga i padituri. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi padinë e paditësit dhe të detyroj të paditurën që paditësit të ia kompensoj shumën prej 1,680,751.14 €, në emër të fitimit të humbur si rezultat i mos përmbushjes së Kontratës nr.1283/11; shumën prej 250,066.64 € në emër të fitimit të humbur nga marketingu dhe sponsorët si dhe shumën prej 32,933.54 € në emër të borxhit nga faturat e papaguara, e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë e deri në përmbushjen përfundimtare të borxhit, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përbarimit me dhunë. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar, në shumë të përgjithshme prej 6,637.50 €.

I padituri në përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Ka theksuar që gjatë procesit gjyqësor qartazi është argumentuar se veprimet juridike të lidhura në mes të palëve, bien në kundërshtim me rendin juridik dhe legjislacionin e aplikueshëm të rendit publik si dhe me dispozitat ligjore tjera urdhëruese lidhur me nënshkrimin e kontratave në pajtim me ligjin dhe se në rastin konkret është evidente se nuk janë vërtetuar pretendimet e paditësit lidhur me padinë e parashtruar dhe kërkesën e saj.

Sa i përket provës së nxjerrur përmes super ekspertizës dhe plotësimit të saj, i padituri ka theksuar që gjatë dëgjimit të përfaqësueses së grupit të ekspertëve G.Sh. në seancën e datës 29.05.2023 dhe gjatë pyetjeve të parashtruara rezulton se super ekspertiza është e punuar duke u bazuar vetëm në pretendime dhe se gjatë procesit gjyqësor është vërtetuar se ekspertiza nuk është bazuar në asnjë provë konkrete dhe të pranueshme, në mënyrë që palët dhe gjykata të binden që rezultati i ekspertizës është i saktë dhe i drejtë.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik pas vlerësimit të provave të administruara ka marr aktgjykimin KE.nr.829/22 të datës 18.08.2023 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Në arsyetim të aktgjykimit, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë ka theksuar se palët kontraktuese në marrëdhënie kontraktuese janë të obliguara t'i kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjëse lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontratat dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke. Ndërsa sipas nenit 154 të LMD-së, përcaktohet se “ai që shkakton dëmin, është i detyruar ta kompensoj atë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”. Bazuar në këto dispozita edhe paditësi ka qenë i detyruar t'i përmbush obligimet kontraktuese në tërësi ashtu siç është paraparë me dokumentet kontraktuese. Mirëpo, pavarësisht dispozitave të sipër cekura, neni 192 i LMD-së, parasheh se i dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose te jetë më i madh nga sa do të ishte zakonisht, ka të 13 drejtë vetëm për kompensim përpjesëtimisht të pakësuar. Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i dëmtuesit, gjykata do të gjykojë kompensimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit. Ndërsa parimet themelore të së drejtës së detyrimeve të parapara me LMD parashohin se palët në marrëdhëniet detyimore duhet të sillen në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të ndershme dhe nuk lejohet shpërdorimi i te drejtave.

Në bazë të këtyre parimeve i dëmtuari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme që pasojat e dëmit të jenë sa më të vogla. Andaj gjykata vlerëson se në rastin konkret, kërkesa e paditësit përtej shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, përkatësisht kërkesa për kompensimin e shumës prej 1,339.943.14 € në emër të fitimit të humbur si rezultat i mos përmbushjes së Kontratës nr.1283/11 dhe shumës prej 250,066.64 € në emër të fitimit të humbur nga marketingu dhe sponsorët, të gjitha këto për tërë periudhën e kontraktuar nga data 14 shkurt 2011 deri me 13 shkurt 2016, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë e deri në përmbushjen përfundimtare të borxhit, bie në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës së detyrimeve, sepse palët në marrëdhëniet detyimore duhet të sillen në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të ndershme dhe nuk lejohet shpërdorimi i te drejtave.

Në bazë të këtyre parimeve i dëmtuari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme që pasojat e dëmit të jenë sa më të vogla. Në rastin konkret rezulton se paditësi pavarësisht se me dispozitën e Nenit 4 të kontratës është përcaktuar se llogaritja e detyrimeve dhe faturimit do të bëhet çdo muaj, ndërsa me Nenin 14 të kontratës përcaktohet se Shtëpia prodhuese pajtohet që Emetuesi RTK nuk është i garantuar me buxhet afatgjatë financiar dhe është paraparë që kontrata mund të ndërpritet në çdo kohë dhe në atë rast i padituri merr përsipër përmbushjen e detyrimeve të krijuara deri në atë kohë, respektivisht pagesën e shpenzimeve 5 mujore, elemente në bazë të cilave paditësi

ka qenë i vetëdijshëm se kontrata mund të shkëputet në çdo kohë dhe pavarësisht se i padituri e ka ndërprere pranimin e emisioneve dhe pagesave si dhe ka nxjerr procesverbalin “Takimi RTK – Grand Media”, të datës 17.04.2013, me konkluzionin për ndërprerje të kontratës, paditësi nuk ka marrë asnjë veprim që ta ndërpresë shkaktimin e dëmit, por ka vazhduar me prodhimin e emisioneve duke injoruar në tërësi ngjarjet e ndodhura, dhe me këtë në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipër cekura, ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e pasojave të dëmit, respektivisht në zgjatjen e periudhës për të cilën tani kërkon kompensimin e dëmit.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore”*.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sipas aktgjykimit të ankimuar, tani për tani, nuk e përkrah Dhoma e Shkallës së Dytë, për shkakun se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës ka gjetur se aktgjykimi i ankimuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave ligjore edhe vërtetëm jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike për të cilën gjykata e shkallës së dytë çdo herë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK dhe e cila shkelje sipas vlerësimit të kësaj gjykate ka ardhur si shkak i vërtetimit jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike me rastin e vendosjes nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar, është kontradiktor dhe në kundërshtim me arsyet mbi faktet vendimtare në të cilat është thirrur gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes, sepse i njëjti është marrë edhe me shkelje procedurale pasi që në rastin konkret nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike.

Në lidhje me pretendimet ankimore të palës së paditësit, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes në arsyetim të aktgjykimit është dashur ti jep të gjitha vlerësimet e saj, në lidhje me të gjitha çështjet e ngritura nga palët ndërgjyqëse. Gjykata e shkallës së parë ka pasur për obligim që në arsyetim të aktgjykimit të trajtojë të gjitha kërkesat e palëve, faktet që i kanë

parashtruar dhe provat ne drejtim te vërtetimit te plote te gjendjes faktike. Prandaj, kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranoj si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, dhe se është juridikisht i paqartë dhe i paqëndrueshëm.

Gjithashtu ne baze te shkesave te lendes dhe pretendimeve ankimore kolegji ka gjetur se, gjykata e shkalles e pare ka bere shkelje te dispozitave thelbësore procedurës kontestimore pasi që gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar me kujdes te veçante secilën prove veç e veç dhe te gjitha se bashku, por ia ka falur besimin vetëm mendimit dhe konstatimit te ekspertit ne super ekspertizën financiarë të datës 30.09.2021 ndërsa nuk ka vlerësuar super ekspertizën financiare dhe plotësimin e saj të datës 20.02.2022 ku ekspertet kanë dhënë mendimin dhe konstatimin e tyre në lidhje me fitimin e humbur gjatë vlefshmërisë së kontratës nga data 14.02.2011 deri me 13.02.2016.

Gjykata e Shkallës së Dytë duke iu referuar nenit 14 të kontratës së lidhur mes të paditësit dhe të paditurës gjeti se palët janë pajtuar që “ *Palët Kontraktuese me marrëveshje, konstatojnë që me këtë kontratë të konkretizojnë bashkëpunimin afarist lidhur me prodhimin me emetimin e emisionit lëndor në këtë kohë të caktuar për periudhën nga 14 Shkurt 2011 deri 13 Shkurt 2016. Kontrata nuk mund të ndërprehet para afatit të paraparë nga njëra palë pa ndonjë arsye, vetëm me anë të marrëveshjes nga dy palët kontrata mund që me marrëveshje të ndërpritet në çdo kohë duke i definuar në mënyre precize të drejtat në mes tyre dhe obligimet që paraqiten deri në momentin e ndërprerjes së kontratës. Në rast se njëra palë ndërprejë bashkëpunimin njëanshëm pa ndonjë arsye të mos respektimit të kësaj marrëveshje atëherë si dëmshpërblim duhet të paguaj shpenzimet pesë (5) mujore. Secila palë kontraktuese mund njëanshëm ta ndërpresë kontratën në rast se pala tjetër kontraktuese nuk i plotëson obligimet e marra me kontratë me atë që në rast të përcaktimit të njëanshëm të ndërprerjes së kontratës, afati i ndërprerjes së kontratës të zgjasë 90 ditë dhe fillon të rrjedhë nga dita e dërgimit të kërkesës për ndërprerje të njëanshme të kontratës në formë të shkruar*”, andaj, bazuar nga provat që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se e paditura ka shkëputur kontratën në mënyrë të njëanshme dhe pa paralajmërim ashtu siç parashihet me nenin e lartcekur. Andaj në pajtim me nenin 173 të LMD-së është krijuar baza ligjore për fitimin e humbur, ndërsa gjykata e shkallës së parë nuk ka pas parasysh me rastin e vendosjes mirëpo ka dhënë arsyetim se paditësi ka qenë i detyruar t`i përmbush obligimet kontraktuese në tërësi ashtu siç është

paraparë me dokumentet kontraktuese duke vënë në kundërshtim gjendjen faktike dhe pa argumentuar me prova konkrete.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka marr me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçante secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, por në mënyrë të njëanshme ia ka falur besimin vetëm mendimit dhe konstatimit të ekspertit në ekspertizës financiare të datës 30.09.2021 e cila pastaj me plotësim ka konstatuar se kontrata nuk është shkëputur asnjëherë pasi që kjo kontratë sipas nenit 14 është dashur të shkëputet me paralajmërim andaj është krijuar baza ligjore për fitimin e humbur dhe fare gjykata në shkallë të parë nuk e ka arsyetuar pse ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë dhe nuk e ka elaboruar fare plotësimin e super ekspertizës.

Andaj, Gjykata e shkallës së parë në ri-procedurë duhet të bëjë administrimin dhe vlerësimin e të gjithave provave materiale veç e veç dhe në mënyrë të tërësishme, ato që gjenden në shkresat e lëndës apo prova të tjera eventuale që do të paraqiteshin nga palët, si dhe duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm për këto pretendime, dhe mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, të sjell një vendim të ligjshëm dhe të drejtë, dhe një dispozitiv të qartë, të kuptueshëm dhe të përmbarueshëm.

Nga të cekurat më lart, e në mbështetje të nenit 194, 195 paragrafi 1, pika c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1664/23 me datë 19.04.2024

Gjyqtarja

Saranda Bogaj Sheremeti